



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 562/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Hani i Elezit, paraqitur kundër Komisionerve të Qenrave të Votimeve, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Hani i Elezit.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, LDK, dega Hani i Elezit ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon, se në QV 3301D/01R dhe në 3301D/02D, në Seçishtë QV 3304D/01R dhe 3304D/02R, si dhe në Gorancë QV 3303D/01R dhe 3303D/02R janë bërë shkelje ligjore dhe manipulim i votës së qytetarit gjatë numërimit.

Parashtruesi i ankesës ka ofruar një deklaratë të përbashkët të disa siç thuhet kandidatëve për këshilltar komunal të Hanit të Elezit si dëshmitar për shkelje e pretenduar.

Pas dyshimit për manipulim gjatë numërimit këta persona kanë informuar Prokurorinë, KKZ, KQZ si dhe Shtabin Zgjedhor të LDK-së.

Në përgjigjen e datës 07.11.2013 të ofruar në PZAP nga KQZ lidhur me pretendimet ankimore për manipulim me vota KQZ ka njoftuar se materiali zgjedhor është duke u proceduar sipas procedurave të brendshme të QNR-së, dhe deri në përfundim të këtij procesi nuk mund të vërtetohet saktësia e pretendimeve ankimore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohej vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar se është bërë manipulim i votës gjatë numërimit në Qendrat e votimit të Lartpërmendura për deri sa KQZ konkretisht QNR është në procedim të numërimit dhe rezultateve përfundimtare, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 562/2013 më datën 07.11.2013



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*